14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 5752 Prot.

Lushnjë, më 16/06/2026

RELACION

"PËR VENDOSJEN E PLLAKAVE PËRKUJTIMORE ME EMRAT E VETERANËVE TË LANÇ"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar: Këshilltare/Këshilltarë

Pranë Institucionit të Bashkisë Lushnjë është paraqitur kërkesa nga Komiteti i Veteranëve , Pasardhësve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për vendosjen e pllakave përkujtimore me emrat e veteranëve të LANÇ. Ky relacion hartohet me qëllim propozimin dhe arsyetimin e vendosjes së pllakave përkujtimore në nderim të veteranëve të luftës, të cilët me kontributin dhe sakrificën e tyre kanë dhënë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e atdheut dhe lirisë së vendit Veteranët e luftës përfaqësojnë vlera të larta patriotike, morale dhe historike për komunitetin dhe kombin. Vendosja e pllakave përkujtimore synon:

- Ruajtjen dhe nderimin e kujtesës historike;
- Vlerësimin institucional dhe qytetar ndaj kontributit të veteranëve;
- Edukimin e brezave të rinj mbi sakrificat për liri dhe pavarësi;
- Pasurimin e hapësirave publike me elementë memorialë dhe historikë

Pllakat përkujtimore do vendosen në fshatin Dushk i Madh në fasadën e murit të jashtëm të shtëpisë së z.Sami Gjyshja. Në fshatin Dushk Peqin në fasadën e qëndrës shëndetësore të këtij fshati .Në fshatin Konjat në fasadën e qëndrës shëndetësore të këtij fshati.Në fshatin Gramsh në fasadën e qëndrës shëndetësore.Në fshatin Zhamë në fasadën e qëndrës

shëndetësore të këtij fshati.Në fshatin Thanasaj në fasadën e qëndrës shëndetësore të këtij fshati. Vendosja e këtyre pllakave përkujtimore do të bëhen me shpenzimet e vet pasardhësve të veteranëve të LANÇ.

Faleminderit për mirëkuptimin !

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 5752 Prot.

Lushnjë, më 16 / 06 /2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 55 DATË 16 / 06 /2026

"PËR VENDOSJEN E PLLAKAVE PËRKUJTIMORE ME EMRAT E VETERANËVE TË LANÇ"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.7, shkronja "b" nenit 54 shkronja "ll" të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar .Ligjit nr.7874 datë 17.11.1994 " Përt statusin e veteranëve të luftës kundër pushtuesve Nazifashistë të popullit shqiptar "JU:

PROPOZOJMË:

I. Miratimin e vendosjes së pllakave përkujtimore në :
   A. Fshati Dushk i Madh në fasadën e murit të jashtëm të shtëpisëtë z. Sami Gjyshja me emrat sipas listës bashkëngjitur.
   B. Fshati Dushk Peqin në fasadën e qëndrës shëndetësore me emrat sipas listës bashkëngjitur.
   C. Fshati Konjat në fasadën e qëndrës shëndetësore me emrat sipas listës bashkëngjitur.
   D. Fshati Gramsh në fasadën e qëndrës shëndetësore me emrat sipas listës bashkëngjitur
   E. Fshati Zhamë në fasadën e qëndrës shëndetësore me emrat sipas listës bashkëngjitur
   F. Fshati Thanasaj në fasadën e qëndrës shëndetësore me emrat sipas listës bashkëngjitur

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia Adiminstrative Dushk, Komiteti i vetaranëve pasardhësve të LANÇ.

III. Vendosja e e pllakave do të bëhet me shpenëzimet e vetpasardhësve të veteranëve të LANÇ.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com